



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 661/2024

Përgjegjësia e institucioneve në raport me dhunën në shkolla

Për:

Znj. Arbërie Nagavci, ministre, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Z. Bashkim Ramosaj, kryetar, Komuna e Deçanit
Z. Bexhet Xheladini, kryetar, Komuna e Dragashit
Z. Burim Berisha, kryetar, Komuna e Fushë Kosovës
Z. Agim Aliu, kryetar, Komuna e Ferizajt
Znj. Ljiljana Shubariq, kryetare, Komuna e Graçanicës
Z. Mehmet Ballazhi, kryetar, Komuna e Hanit të Elezit
Z. Ilir Ferati, kryetar, Komuna e Istogut
Z. Besim Ilazi, kryetar, Komuna e Kaçanikut
Z. Kadri Rahimaj, kryetar, Komuna e Kamenicës
Z. Zenun Elezaj, kryetar, Komuna e Klinës
Z. Vladan Bogdanoviq, kryetar, Komuna e Klllokotit
Z. Imri Ahmeti, kryetar, Komuna e Lipjanit
Z. Ekrem Kastrati, kryetar, Komuna e Malishevës
Z. Abdylhadi Krasniç, kryetar, Komuna e Mamushës
Z. Bedri Hamza, kryetar, Komuna e Mitrovicës së Jugut
Z. Sasha Milosheviq, kryetar, Komuna e Novobërdës

Z. Xhafer Gashi, kryetar, Komuna e Obiliqit
Z. Dragan Petković, kryetar, Komuna e Parteshit
Z. Gazmend Muhaxheri, kryetar, Komuna e Pejës
Z. Shpejtim Bulliqi, kryetar, Komuna e Podujevës
Z. Përparim Rama, kryetar, Komuna e Prishtinës
Z. Shaqir Totaj, kryetar, Komuna e Prizrenit
Z. Smajl Latifi, kryetar, Komuna e Rahovecit
Znj. Katarina Ristiç-Iliq, kryetare, Komuna e Ranillugut
Z. Dalibor Jevtiq, kryetar, Komuna e Shtërpçës
Z. Qemajl Aliu, kryetar, Komuna e Shtimes
Z. Fadil Nura, kryetar, Komuna e Skenderajt
Z. Bali Muharremaj, kryetar, Komuna e Therandës
Z. Sokol Haliti, kryetar, Komuna e Vitisë
Z. Ferit Idrizi, kryetar, Komuna e Vushtrrisë
Z. Erden Atiq, kryetar, Komuna e Mitrovicës së Veriut
Z. Izmir Zeqiri, kryetar, Komuna e Zubin Potokut
Z. Ilir Peci, kryetar, Komuna e Zveçanit
Z. Lulzim Hetemi, kryetar, Komuna e Leposaviqit
Z. Ramiz Lladrovci, kryetar, Komuna e Glllogocit
Z. Ardian Gjini, kryetar, Komuna e Gjakovës
z. Ruzhdi Shehu, kryetar, Komuna e Junikut
Z. Alban Hyseni, kryetar, Komuna e Gjilanit

Kopje:

Z. Habit Hajredini, drejtor, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të mirë

Prishtinë, 28 maj 2025

QËLLIMI I RAPORTIT

Qëllimi i këtij Raporti është të tërheqë vëmendjen e institucioneve publike lidhur me detyrimet pozitive që kanë për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në shkolla. Raporti gjithashtu do të japë rekomandime specifike dhe konkrete lidhur me veprimet që duhet t'i ndërmarrin institucionet përkatëse lidhur me parandalimin dhe trajtimin e dhunës në shkolla.

Shkollat, si institucione edukuese, luajnë një rol të shumëfishtë në shoqëri. Para së gjithash, ato kanë për detyrë të edukojnë nxënësit me shkathtësi dhe njohuri të nevojshme për jetën, duke siguruar që kjo të ndodhë në një mjedis të sigurt. Fatkeqësisht, shumë shpesh, nxënësvë në Kosovë u mohohet e drejta themelore për të qenë të sigurt në shkolla, për shkak të pranisë së formave të ndryshme të dhunës. Prania e dhunës në shkolla, përveç se cenon të drejtën themelore të fëmijëve për siguri, tregon dështimin e të rriturve dhe institucioneve për të ofruar një mjedis të sigurt dhe dobëson seriozisht mundësinë e tyre për të marrë një arsim cilësor.

Frekuentimi i mjediseve të pasigurta shkollore, përjetimi i llojeve të shumta të dhunës, lëndimet fizike dhe psikologjike, seksuale, vrasjet e fëmijëve si rezultat i dhunës në shkolla, janë të lidhura drejtpërdrejt me përgjegjësinë e institucioneve shtetërore për njohjen dhe adresimin me urgjencë të kësaj problematike.¹

BAZA LIGJORE

1. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatin e Popullit), përveç tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës);*
- *Avokati i Popullit mund të japë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe²organeve tjera shtetërore (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës);*
- *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, i Ligjit për Avokatin e Popullit);*
- *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, i Ligjit për Avokatin e Popullit);*
- *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, i Ligjit për Avokatin e Popullit).”*

¹<https://www.koha.net/kronike/vrasja-e-14-vjecarit-ne-prishtine-nxenesi-u-ther-me-thike-derisa-po-shkonte-ne-shkolle>; <https://telegrafi.com/14-vjecari-u-vra-per-hakmarrje>; <https://kallxo.com/lajm/skandal-ne-vushtrri-mesuesi-63-vjecar-akuzohet-se-ngacmoi-seksualisht-nxeneset-e-klases-se-6-te/>; <https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1177/01430343221081994>; <https://nacionale.com/video/12-vjecari-problematik-ne-shtime-institucionet-skane-zgjidhje-pamje-te-renda>; <https://veriu.info/skandal-ne-shkollen-abdullah-shabani-ne-mitrovic-nena-demonon-dhunen-ndaj-djalit-te-saj>; R.nr. 56/2025; R.137/2025; R. nr. 182/2025; R.445/2025.

KORNIZA LIGJORE DHE ANALIZA E ÇËSHTJES

2. Ekzistojnë një varg instrumentesh ligjore që e rregullojnë këtë çështje, por pa u kufizuar te Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila në nenin 50 (Të Drejtat e Fëmijës) përcakton: *“1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.”* Ndërsa paragrafi 3 i këtij neni thotë: *“Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.”* Kurse paragrafi 4 i këtij neni thotë: *“Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”* Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, përfshirë edhe të drejtat e fëmijës. Zbatimi dhe realizimi në praktikë i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Kushtetuta shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha institucioneve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut,³ dhe në rastet kur kemi të bëjmë me fëmijë, të gjitha veprimet e ndërmarra nga këto institucione duhet të jenë në interesin më të mirë të tyre. Kushtetuta, pos të tjerash, parasheh se fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre dhe se secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.⁴ Kjo e drejt përfshin edhe mbrojtjen nga dhuna dhe abuzimi seksual. Rrjedhimisht, organet shtetërore obligohen për ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për ta siguruar mbrojtjen e fëmijës nga abuzimet dhe keqpërdorimet, si dhe mbrojtje të tjera në të gjitha fushat e jetës, që janë në interes të mirëqenies së tyre.
3. Kushtetuta në nenin 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) përcakton: *“Të drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (...) (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (...) (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës. (9) Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.”*
4. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm: KDF), në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: *“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”* Më tej KDF-ja në nenin 19, përcakton: *“1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar. (...)”* Në kontekstin e këtij neni institucionet arsimore duhet të krijojnë një mjedis të sigurt ku çdo formë e dhunës trajtohet me seriozitet dhe ku fëmijët kanë mundësinë të raportojnë pa frikë nga ndëshkimi apo stigmatizimi. Për më tepër ky nen thekson përgjegjësinë e autoriteteve përgjegjëse për të siguruar mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve në çdo sferë

³ Kushtetuta, neni 21.

⁴ Kushtetuta, neni 50, para.1 dhe 3.

të shoqërisë përfshirë në shkolla përmes bashkëpunimit ndërinstitucional dhe angazhimit të akterëve të ndryshëm për zbatimin efektiv të masave mbrojtëse.

5. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Evropiane).

6. Gjykata Evropiane ka trajtuar raste me pretendime të shkeljeve të të drejtave të njeriut, e më saktësisht të fëmijëve, në disa raste ku ka ndodhur dhuna në shkolla. Në rastin *Biba kundër Shqipërisë* (Aktgjykim i 7 majit 2024), GJEDNJ trajtoi parimet e përgjithshme që i ka sqaruar në rastet e mëparshme të saj për dhunën në shkolla në rastin *Durđević kundër Kroacisë* (Aktgjykim i 18 tetorit 2011 paragrafët 106–107), duke theksuar:

“106. Ndërsa objekti thelbësor i nenit 8 është mbrojtja e individit nga ndërhyrjet arbitrare nga autoritetet publike, ai nuk e detyron Shtetin thjesht që të mos ndërhyjë: përveç kësaj ndërmarrjeje negative, mund të ketë detyrime pozitive të qenësishme për respektimin efektiv të jetës private apo familjare. Këto detyrime mund të përfshijnë miratimin e masave të krijuara për të siguruar respektimin e jetës private edhe në sferën e marrëdhënieve të individëve ndërmjet tyre (shihni X dhe Y kundër Holandës, 26 mars 1985, § 23, seria A, nr. 91; Botta kundër Italisë, 24 shkurt 1998, § 33, Raportet e Vendimeve 1998 I; Mikulić, cituar më lart, § 57; dhe Sandra Janković kundër Kroacisë, nr. 38478/05, § 44, GJEDNJ 2009 ... (ekstrakte)).

107. Për sa i përket respektimit të jetës private, Gjykata është shprehur më parë, në kontekste të ndryshme, se koncepti i jetës private përfshin integritetin fizik dhe psikologjik të një personi. Sipas nenit 8, Shtetet kanë për detyrë të mbrojnë integritetin fizik dhe moral të një personi nga persona të tjerë. Për këtë qëllim, ato duhet të ruajnë dhe të zbatojnë në praktikë një kuadër ligjor të duhur që ofron mbrojtje kundër akteve të dhunës nga persona privatë (shihni X dhe Y, cituar më lart, §§ 22 dhe 23; Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 mars 1993, § 36, seria A, nr. 247- C; D.P. dhe J.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 38719/97, § 118, 10 tetor 2002; M. C. kundër Bullgarisë, nr. 39272/98, §§ 150 dhe 152, GJEDNJ 2003 XII; Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë, nr. 71127/01, § 65, 12 qershor 2008; dhe Sandra Janković, cituar më lart, § 45).”

7. Gjykata Evropiane duke arsyetuar në rastin *Biba kundër Shqipërisë*, theksoi në paragrafin 59 se në kuadrin e ofrimit të një shërbimi të rëndësishëm publik siç është arsimi, roli thelbësor i autoriteteve arsimore është të mbrojnë shëndetin dhe mirëqenien e studentëve, duke pasur parasysh, veçanërisht, cenueshmërinë e tyre për shkak të moshës së tyre të re. Kështu, detyra parësore e autoriteteve arsimore është të garantojnë sigurinë e studentëve për t'i mbrojtur ata nga çdo formë dhune gjatë kohës që ata janë nën mbikëqyrjen e autoriteteve arsimore. Më tej, Gjykata Evropiane theksoi në paragrafin 60 se për sa i përket disiplinës shkollore, Gjykata është shprehur se ajo përfshihet në fushën e së drejtës për arsim dhe se shteti nuk mund të zhvishet nga përgjegjësia, duke deleguar detyrimet e tij tek organet ose personat privatë (shihni dhe *Durđević*, cituar më lart, paragrafi 104).

8. Mes paragrafëve reflevant, GEJDNJ në rastin *Biba kundër Shqipërisë* theksoi në paragrafin 67 si në vijim:

“67. Lidhur me mbrojtjen e integritetit fizik dhe psikologjik të një personi nga persona të tjerë, Gjykata ka vendosur më parë se detyrimet pozitive të autoriteteve – në disa çështje sipas neneve 2 ose 3 të Konventës dhe në çështje të tjera sipas nenit 8, të marra vetëm ose

në kombinim me nenin 3 – mund të përfshijnë detyrimin për të ruajtur dhe zbatuar në praktikë një kuadër ligjor të duhur që ofron mbrojtje kundër akteve të dhunës nga persona privatë (shihni Söderman, cituar më lart, § 80, me referenca të mëtejshme). Në kontekstin e dhunës në shkollë, Gjykata thekson se, në përputhje me parimet e mësipërme, sipas nenit 8 që kërkon mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë dhune ose abuzimi në institucionet arsimore (shihni paragrafët 58–60 më lart), dhe me standardet përkatëse ndërkombëtare (shihni paragrafin 28 më lart), autoritetet e brendshme duhet të vendosin masat e duhura legislative, administrative, sociale dhe edukative për të ndaluar pa mëdyshje çdo sjellje të tillë kundër fëmijëve, në çdo kohë dhe në çdo rrethanë, dhe, në këtë mënyrë, të sigurojnë zero tolerancë ndaj çdo forme dhune ose abuzimi në institucionet arsimore. Kjo lidhet edhe me domosdoshmërinë e sigurimit të llogaridhënies përmes rrugëve të përshtatshme penale, civile, administrative dhe profesionale. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se shteti gëzon diskrecion në përcaktimin e mënyrës se si do të organizojë sistemin e tij për të siguruar pajtueshmërinë me Konventën (shihni F. O., cituar më lart, § 91).”

9. Më tej, GJEDNJ në po të njëjtin rast (Biba kundër Shqipërisë) theksoi se:

72. Në çështjen në fjalë, nuk kontestohet fakti që ngjarja në fjalë ka ndodhur në ambientet e shkollës gjatë orarit të rregullt të shkollës dhe që autori, i cili ka kryer veprime me rrezikshmëri të lartë, ka qenë nxënës i asaj shkolle. Pritet që institucionet arsimore të marrin masat e duhura për të parandaluar përdorimin e objekteve të rrezikshme nga nxënësit në ambientet e shkollës ose në mbikëqyrje. Gjuajtja e një objekti të fortë me shirit llastiku ndaj një nxënësi tjetër është potencialisht e rrezikshme dhe mund të çojë në dëmtime serioze, siç ndodhi në këtë rast.

73. Edhe pse nuk mund të pritet që stafi mësimor të sigurojë mbikëqyrje të vazhdueshme të çdo nxënësi në mënyrë që t'i përgjigjet menjëherë çdo sjelljeje të paparashikueshme, autoritetet e shkollës janë përgjegjëse për disiplinën e shkollës, sidomos mes nxënësve të saj, në çdo kohë kur nxënësit janë në shkollë, apo edhe jashtë saj, por nën mbikëqyrjen e shkollës (krahasoni Kayak, cituar më lart, § 60). Përndryshe, mbrojtja e të miturve gjatë orarit të mësimi nuk do të garantohej, pasi asnjë autoritet nuk do të mbante përgjegjësi për sigurinë e tyre gjatë pushimeve. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se gjykatat kombëtare konstatuan se shiritat e llastikut, si ato me të cilat u qëllua një objekt ndaj djalit të kërkuesit, ishin përdorur për lidhjen e kartëmonedhave, por shkolla nuk arriti të shpjegonte pse nxënësit njëmbëdhjetëvjeçarë kanë nevojë për llastikë që të mbajnë të lidhura para xhepi. Kërkuesi pretendoi se një nxënës tjetër kishte sjellë njëzet llastiqe në shkollë dhe i kishte shpërndarë mes nxënësve, të cilët i kishin përdorur haptazi në ditët para incidentit. Këto pretendime të kërkuesit nuk u vunë në shqyrtim ose nuk u trajtuan në mënyrën e duhur nga gjykatat e brendshme në vendimet e tyre të arsyetuara.

74. Sa i përket masave që shkolla mori pas incidentit, gjykatat e brendshme konstatuan që ajo kishte mbledhur donacione nga prindërit e nxënësve të tjerë dhe kishte kontaktuar kompaninë e saj të sigurimit, duke i kërkuar të paguante shpenzimet e trajtimit mjekësor të djalit të kërkuesit (shihni paragrafët 7 dhe 9 më lart). Megjithatë, pretendimet faktike të ngritura nga kërkuesi nuk u adresuan, domethënë që ai nuk ishte informuar menjëherë për incidentin dhe autoritetet e shkollës nuk kishin reaguar menjëherë për të siguruar që djali i tij të merrte trajtim mjekësor urgjent. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësimin e vet për këto

pretendime; gjykatat e brendshme duhet t'i kishin shqyrtuar siç duhej në vendimet e tyre të arsyetuara."

10. Nga aktgjykimi i lartcekur i Gjykata Evropiane, mund të konstatohet se sa i përket parandalimit dhe adresimit të dhunës në shkolla, autoritetet publike duhet të kenë parasysh se (i) se në kuadrin e ofrimit të një shërbimi të rëndësishëm publik siç është arsimi, roli thelbësor i autoriteteve arsimore është të mbrojnë shëndetin dhe mirëqenien e studentëve, duke pasur parasysh, veçanërisht, cenueshmërinë e tyre për shkak të moshës së tyre të re, dhe rrjedhimisht është detyrë parësore e autoriteteve arsimore të garantojnë sigurinë e nxënësve për t'i mbrojtur ata nga çdo formë dhune gjatë kohës që ata janë nën mbikëqyrjen e autoriteteve arsimore; (ii) sa i përket disiplinës shkollore, kjo e fundit përfshihet në fushën e së drejtës për arsim; (iii) në kontekstin e dhunës në shkollë, sipas nenit 8 që kërkon mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë dhune ose abuzimi në institucionet arsimore autoritetet publike duhet të vendosin masat e duhura legislative, administrative, sociale dhe edukative për të ndaluar pa mëdyshje çdo sjellje të tillë kundër fëmijëve, në çdo kohë dhe në çdo rrethanë, dhe, në këtë mënyrë, të sigurojnë zero tolerancë ndaj çdo forme dhune ose abuzimi në institucionet arsimore; dhe detyrimi i rëndësishëm që (iv) edhe pse nuk mund të pritet që stafi mësimor të sigurojë mbikëqyrje të vazhdueshme të çdo nxënësi në mënyrë që t'i përgjigjet menjëherë çdo sjelljeje të paparashikueshme, autoritetet e shkollës janë përgjegjëse për disiplinën e shkollës, sidomos mes nxënësve të saj, në çdo kohë kur nxënësit janë në shkollë, apo edhe jashtë saj, por nën mbikëqyrjen e shkollës, e kjo me qëllimin që të arrihet mbrojtja e fëmijëve dhe siguria e tyre edhe gjatë pushimeve.
11. Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 14/17 korrik 2019, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: LMF), ka për qëllim, pos të tjerash: *"të mbrojë fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës;"* duke marrë për bazë parimet për mbrojtjen e tij, si: të drejtën për jetë; për mbijetesë dhe zhvillim; për interesin më të mirë të fëmijës; për zhvillimin gradual të tij; për respektimin e pikëpamjes së tij dhe për mos diskriminim. Tutje LMF-ja në nenin 37 ka përcaktuar ndalimin e privimit të fëmijës nga e drejta për edukim dhe arsimim,⁵ ndërsa në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, fëmija mbrohet nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimi, keqpërdorimi, shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, neglizhenca, apo ndonjë formë tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës. Fëmija mbrohet nga dhuna e shfaqur qoftë nga personeli arsimor, bashkëmoshatarët dhe nga secili person tjetër, brenda sistemit edukativ arsimor. Në procesin edukativ dhe arsimor, është e ndaluar të promovohet gjuha e urrejtjes, dhuna, jo toleranca, diskriminimi dhe format e tjera që nxisin konflikte ndër njerëzore.⁶ Për më tepër ky nen garanton sigurimin e mekanizmave efikas për parandalim, trajtim brenda shkollës dhe raportim tek autoritetet përgjegjëse të rasteve të dhunës dhe dukurive të tjera negative.⁷ Andaj ky nen është thelbësor për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në shkolla dhe ndalon çdo formë dhune nga stafi arsimor, bashkëmoshatarët dhe të tjerët dhe përfshin po ashtu obligimin për raportim të dhunës në shkolla.

⁵ LMF, neni 37, paragrafi 1.

⁶ LMF, neni 37, paragrafi 3.

⁷ LMF, neni 37, paragrafi 5, nën paragrafi 5.9.

12. LMF-ja konkretisht në nenin 38, paragrafi 3, e ndalon personelin arsimor në përdorim të ndëshkimit trupor *“Personeli arsimor dhe personeli i lidhur me shkollën nuk duhet të përdorin ndëshkimin trupor si mjet disipline dhe rregulli duhet të bazohet dhe ndërtohet mbi bazën e respektit dhe drejtësisë.”* Ndërsa paragrafi 4, i këtij neni obligon drejtoritë komunale dhe inspektoratin e arsimit për masa disiplinore ndaj ushtruesve të dhunës në shkolla: *“Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Inspektorati i Arsimit merr masa disiplinore ndaj personelit arsimor si dhe i raporton organeve të hetuesisë rastet e ndëshkimit trupor të fëmijës, në përputhje me ligjet në fuqi.”* Për më tepër paragrafi 5 i këtij neni obligon ministrinë përkatëse për nxjerrjen e programeve të rritjes së ndërgjegjësimit për efektet e dëmshme të ndëshkimit trupor: *“ 5.1 Edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me pasojat degraduese të ndëshkimit trupor. 5.2 Programe prindërimi, që promovojnë mënyrat jo të dhunshme të disiplinimit në familje dhe institucione edukativo arsimore dhe në institucione të kujdesit.”*
13. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovë (LAPRK)⁸ rregullon edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it⁹, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele. Për më tepër neni 1, paragrafi 2, i LAPRK-së i referohet dispozitës kushtetuese për të drejtën për arsimim duke thënë se qëllimi i arsimit dhe i aftësimit parauniversitar përfshin zhvillimin e plotë të personalitetit, dhuntisë dhe aftësive mendore dhe fizike të nxënësit. I njëjti parim përsëritet në nenin 3, paragrafi 3, duke theksuar: *“Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera (...) për t’u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.”* Konkretisht neni 4 paragrafi 2 i këtij ligji shprehimisht ka përcaktuar: *“Ndalohej ndëshkimi fizik apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit nënçmues në të gjitha institucionet arsimore dhe aftësuese, qofshin ato publike ose private.”*
14. LAPRK në neni 7, ka përcaktuar kompetencat e komunës konkretisht në sigurimin e një ambienti të shëndetshëm, duke përfshirë ujin e pijshëm, kushtet higjieniko-sanitare, shërbimin shëndetësor, si dhe ambient të sigurt për nxënësit dhe personelin duke përfshirë sigurimin e shërbimeve të sigurta dhe sigurisë efektive, ndërsa përmes bashkëpunimit me prindër, polici dhe autoritetet e tjera publike, marrin hapa për të adresuar sjelljet e dhunshme dhe keqpërdorimin në ose në lidhje me institucionin përkatës. Sipas nenit 22, komuna, pas pranimit të propozimit të këshillit drejtues të shkollës, miraton rregullat e parapara për të promovuar sjelljen e mirë dhe disiplinën e nxënësve, dhe për të promovuar konceptin e shkollave të shëndetshme dhe eliminimin e dhunës. Rrjedhimisht komunat duhet të marrin hapa proaktivë për të parandaluar dhe trajtuar dhunën në shkolla, duke krijuar një mjedis arsimor të mbrojtur dhe mbështetës për të gjithë nxënësit.
15. Rregullore QRK- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar (në tekstin e mëtejme Rregullorja nr. 21/2013)¹⁰ përcakton detyrimet, qartëson rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin, raportimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit para-universitar si dhe përforcon bashkëpunimin

⁸ Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (GZRK) më 16 shtator 2011; <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

⁹ LAPRK, neni 2, paragrafi 1, nën paragrafi 1.21.

¹⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10292>

ndërinstitucional dhe multidisiplinar për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe për tu mbrojtur fëmijët nga dhuna. Në kapitullin e parë të kësaj rregulloreje, përkufizohen termet kryesorë si dhuna, dhuna fizike, dhuna verbale, keqtrajtimi, neglizhimi, ngacmimi në mes bashkëmoshatarëve, dhuna seksuale, abuzimi seksual, shfrytëzimi seksual komercial, dhuna digjitale, dhuna emocionale/ psikologjike. Kapitulli i dytë përshkruan masat parandaluese, të cilat përfshijnë edukimin e nxënësve dhe stafit për format e dhunës dhe mënyrat e raportimit të saj, si dhe krijimin e një mjedisi shkollor mbështetës. Ky kapitull po ashtu klasifikon institucionet që merren me parandalimin dhe reagimin ndaj veprimeve të dhunshme në institucionet arsimore parauniversitare në dy nivele: “1.1. Rrjeti i brendshëm mbrojtës: Edukimi parashkollor – (Drejtori i Institucionit, Këshilli i Prindërve) dhe Shkollat (Drejtori i shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli Drejtues i Shkollës dhe Këshilli i Nxënësve); 1.2. Rrjeti i jashtëm mbrojtës: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më tej: MASHT)- (Sektorët e Inspektimit të Arsimit në Rajon), Këshilli i Prindërve të Kosovës, Këshilli i Nxënësve në nivel nacional), Drejtoria Komunale e Arsimit (më tej: DKA) - (Këshilli i Nxënësve dhe Këshilli i Prindërve në nivel komunal, Zyrtari përkatës për të Drejtat e Fëmijës), Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (më tej: DShMS)- (Qendra për Punë Sociale (më tej: QPS), Qendrat e Mjekësisë Familjare (më tej: QMF), Ministria e Drejtësisë (më tej: MD) - (Shërbimi Sprovues i Kosovës (më tej: ShSK), Shërbimi Korrektues i Kosovës (më tej: SHKK)), Policia e Kosovës (më tej: PK) si dhe Mekanizmat tjerë ndihmës- (Mediat, Institucioni i Avokatit të Popullit, organizatat joqeveritare që punojnë për të drejtat e fëmijëve dhe çështjet e dhunës në shkollë).”

POLITIKAT DHE PLANET STRATEGJIKE

16. Strategjia nacionale për siguri në bashkësi dhe plani i veprimit 2018 – 2023¹¹ adreson një sërë çështjesh të sigurisë me të cilat përballen qytetarët e Kosovës çdo ditë, duke përfshirë edhe sigurinë në shkolla. Siguria në përgjithësi sipas strategjisë përfshin ruajtjen e pronës publike dhe private, qasjen më të lehtë në shërbimet shëndetësore dhe administrative, dhe sigurinë personale në rrugë, shtëpi dhe shkolla. Një nga objektivat kryesore ka qenë zhvillimi i modelit nacional të Planit për Menaxhim të Fatkeqësive në Shkolla, i cili do të hartohej dhe aprovohej nga bartësit e përgjegjësive përkatëse. Ky model synonte të përmirësojë reagimin ndaj emergjencave në shkolla dhe të sigurojë një mjedis të sigurt për nxënësit dhe stafin arsimor. Kjo është e rëndësishme për faktin e rrezikut potencial të dhunës në shkolla. Gjithashtu, ka qenë i planifikuar pilotimi i Planit për Menaxhim të Fatkeqësive dhe mbështetja e shkollave për krijimin e ekipeve për menaxhimin e emergjencave si objektiv kyç. Në këtë kuadër, institucionet arsimore do të krijojnë plane për menaxhimin e emergjencave dhe do të themelojnë ekipe të specializuara për këtë qëllim. Një objektiv tjetër i rëndësishëm është sensibilizimi i qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme përmes organizimit të ligjëratave, debateve dhe kampeve në shkolla. Këto aktivitete synojnë të rrisin ndërgjegjësimin e nxënësve dhe komunitetit për kërcënimet e sigurisë dhe të promovojnë një kulturë të respektit dhe mirëqenies në shkolla.

¹¹ <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/51/STRATEGJIA%20NACIONALE%20P%C3%8BR%20SIGURI%20N%C3%8B%20BASHK%C3%8BSI%20DHE%20PLANI%20I%20VEPRIMIT%202018%20-%202023.pdf>

17. Strategjia e Arsimit 2022-2026 (SA)¹² ka vendosur në një fokus të veçantë krijimin e mjediseve shkollore të shëndetshme, të sigurta dhe të përshtatshme sipas normave dhe standardeve. Një nga objektivat specifike është sigurimi i këtyre mjediseve për të mundësuar një mësim cilësor. Për të arritur këtë, strategjia përfshin planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve që kontribuojnë në parandalimin dhe raportimin e të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë dhunën fizike, psikologjike, seksuale, neglizhimin, ngacmimin seksual, shfrytëzimin, homofobinë, bullizmin, gjuhën e urrejtjes dhe ekstremizmin në shkolla. Gjithashtu, theksohen aktivitetet që ndërlidhen me obligimet e institucioneve arsimore për të identifikuar, referuar dhe mbështetur fëmijët që janë viktimë të drejtpërdrejta të dhunës në shtëpi ose dëshmitarë të dhunës në familje. Treguesit e ndikimit për këtë objektiv përfshijnë përqindjen e rasteve të menaxhuara të të gjitha formave të dhunës të identifikuar në shkolla, përfshirë abuzimin dhe ngacmimin seksual, bullizmin dhe ekstremizmin. Këto masa synojnë të krijojnë një mjedis arsimor të sigurt dhe mbështetës për të gjithë nxënësit dhe stafin arsimor, duke siguruar që të gjitha format e dhunës të adresohen në mënyrë efektive dhe gjithëpërfshirëse.

ZBATIMI I MEKANIZMAVE TË RAPORTIMIT TË DHUNËS NË KUADËR TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË INFORMATAVE NË ARSIM (SMIA)

18. SMIA është akronim për “Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim”, një sistem që organizon në mënyrë sistematike informacione bazë për menaxhimin dhe zhvillimin e arsimit. Ky sistem shërben si qendër informacioni jo vetëm për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), por edhe për nivelin komunal, duke ndihmuar në zhvillimin dhe monitorimin e politikave arsimore në nivel shkollor, komunal dhe qendror. Përdorimi i të dhënave nga SMIA kontribuon në krijimin e politikave arsimore më të drejta dhe efektive. Çdo komunë ka emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e vet, duke pasur kështu qasje në shkollat brenda territorit të saj gjeografik. Sistemi në nivel komunal përbëhet prej gjashtë moduleve, ku secili modul ka specifikat e veta dhe detajet e përgjithshme të tyre do të ofrohen në vazhdim.
19. Më 22 korrik 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kërkoi nga MASHTI statistikën lidhur me rastet e dhunës në shkolla për pesë vitet e fundit ose për periudhën që i kanë të disponueshme, të mbledhura nga sistemi SMIA si dhe informata apo dokumente tjera relevante, që konsiderohen se mund të ndihmojnë dhe plotësojnë të dhënat për çështjen. Më 22 korrik 2024, MASHTI ofroi informatat e nevojshme lidhur me rastin.
20. Informacioni nga raporti i MASHTI-t identifikon disa arsye pse SMIA nuk funksionon mirë. Disa nga arsyet kryesore:

Mos raportimi

Edhe pse SMIA përfshin një modul për raportimin e incidenteve në shkolla, numri i raportimeve ndër vite ka qenë relativisht i ulët. Kjo sugjeron një hezitim midis drejtorëve të shkollave dhe personelit mësimdhënës për të raportuar incidente, ndoshta për të ruajtur imazhin e shkollës.

Trajnimi dhe ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm

Personeli i shkollave mund të mos jetë plotësisht i informuar mbi rëndësinë e raportimit të incidenteve dhe se si të përdorë SMIA në mënyrë efektive. Trajnimi i vazhdueshëm është

¹² <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/03-Strategjia-e-Arsimit-2022-2026-Alb-Web.pdf>

i nevojshëm pasi personeli i shkollës ndryshon dhe jo të gjithë që vijnë në menaxhment kanë informacionet e duhura për mënyrën e trajtimit të rasteve të dhunës.

Çështjet e koordinimit

Edhe pse ka përpjekje për të koordinuar me institucione të tjera si Policia e Kosovës, duket se mungon një komunikim dhe bashkëpunim i vazhdueshëm dhe efektiv. Kjo mund të çojë në nën-raportim dhe trajtim të pamjaftueshëm të rasteve.

Burimet dhe mbështetja e pamjaftueshme

Ka nevojë për më shumë burime, përfshirë një numër të shtuar të inspektorëve dhe psikologëve shkollor, për të mbështetur shkollat në zbatimin efektiv të politikave.

Rezistenca kulturore dhe institucionale

Ekziston një tendencë normative dhe kulturore midis disa drejtuesve të shkollave për të fshehur incidentet për të prezantuar shkollat e tyre si pa probleme dhe pa dhunë. Kjo mendësi duhet të ndryshojë për të siguruar transparencë dhe për të përmirësuar efektivitetin e sistemit.

Sfidat teknike dhe logjistike

Zbatimi dhe funksionaliteti i SMIA-s mund të ndikohen nga çështjet teknike dhe logjistike që ende nuk janë adresuar plotësisht, duke kufizuar kapacitetin e sistemit për të trajtuar dhe raportuar incidentet në mënyrë të plotë.

Mbështetja politike dhe zbatimi i ligjeve

Ndërsa ka përpjekje të konsiderueshme për të zhvilluar veprime dhe politika ligjore, zbatimi dhe forcimi aktual i këtyre politikave në nivel shkollor mund të jetë i mangët.

21. Sipas të dhënave nga MASHTI¹³ në përgjithësi numri i rasteve të raportuara në SMIA është si vijon:

- Viti shkollor 2014-2015: 17 raste të dhunës të raportuara.
- Viti shkollor 2015-2016: 43 raste të dhunës të raportuara.
- Viti shkollor 2016-2017: 28 raste të dhunës të raportuara.
- Viti shkollor 2017-2018: 18 raste të dhunës të raportuara.
- Viti shkollor 2018-2019: 22 raste të dhunës të raportuara.
- Viti shkollor 2019-2020: 18 raste të dhunës të raportuara.
- Viti shkollor 2020-2021: 15 raste të dhunës të raportuara.
- Viti shkollor 2021-2022: 39 raste të dhunës të raportuara.
- Viti shkollor 2022-2023: 45 raste të dhunës të raportuara.
- Viti shkollor 2023-2024: 27 raste të dhunës të raportuara


22. Më 22 korrik 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kërkoi nga Policia e Kosovës statistikën lidhur me raportimin e rasteve të dhunës në shkolla për pesë vitet e fundit, ose për periudhën që i kanë të dhënat e disponueshme, si dhe informata apo dokumente tjera

¹³ MASHTI, dt.22.07.2024

relevante, që konsiderohen se mund t'i ndihmojnë dhe plotësojnë të dhënat për çështjen. Më 6 gusht 2024, Policia e Kosovës i ofroi informatat e nevojshme lidhur me rastin.


23. Analiza e të dhënave të pranuar nga Policia e Kosovës tregon se muajt me numrin më të lartë të rasteve të dhunës në total ndër vite (duke përjashtuar vitin 2024) në shkolla janë marsi (656), nëntori (620), maji (554), tetori (553) dhe shkurti (519). Këta muaj kanë përjetuar një numër të konsiderueshëm incidentesh, që sugjerojnë se periudha gjatë vitit shkollor është më e prirë për incidente dhune. Për të trajtuar këtë problem, mund të jenë të nevojshme ndërhyrje dhe programe specifike gjatë këtyre muajve për të reduktuar dhunën në shkolla. Numri i rasteve në korrik dhe gusht është përgjithësisht më i ulët, përveç disa viteve si 2015 dhe 2022 kur pati rritje të papritur. Kjo rritje mund të jetë e lidhur me aktivitetet jashtëshkollore ose ngjarje të tjera të jashtëzakonshme. Në vitin 2015, korriku ka një numër të pazakontë të lartë të rasteve (95), gjë që mund të sugjerojë një ngjarje specifike që shkaktoi rritjen e rasteve gjatë verës (shih Grafikoni 1). Analizat në grafikon nuk kanë qenë pjesë e raportit të policisë por janë krijuar për qëllime të këtij raporti. Në përgjithësi, ka një rritje të dukshme të rasteve nga viti 2013 deri në vitin 2017, me një kulm në vitin 2017 (594 raste). Viti 2020 shënon një rënie të madhe të rasteve (221), e cila mund të jetë ndikuar nga pandemia COVID-19 dhe mbyllja e shkollave. Pas vitit 2020, numri i rasteve filloi të rritet përsëri, me një stabilizim në vitet 2021-2023.

24. Grafikoni 1 - Numri i rasteve të dhunës në shkolla të raportuar në policinë e Kosovës



25. Sa i përket analizës për muaj më shumti raste të dhunës janë raportuar për muajt mars, nëntor dhe maj, ndërsa më të ulta për muajt korrik dhe gusht (shih Grafikoni 2).

26. Grafikoni 2 - Numri i rasteve të dhunës të raportuar në polici sipas muajve të vitit



27. Nëse mesatarisht konsiderojmë se kemi 37 javë mësimi në vendin tonë, atëherë për vitin 2023 rezulton që çdo ditë shkollore në Kosovë janë raportuar në polici afërsisht 3 raste të dhunës në shkollë. Ekziston një ndryshim i madh midis numrit të rasteve të raportuara nga Policia e Kosovës dhe atyre të raportuara nga SMIA, ku rastet e raportuara nga Policia e Kosovës janë dukshëm më të larta. Të dy sistemet tregojnë dallime në numrin e rasteve të raportuara ndër vite. Për shembull, të dyja sistemet shënojnë një numër të ulët rastesh gjatë vitit shkollor 2020-2021, ndoshta për shkak të ndikimit të pandemisë COVID-19. Rastet e raportuara nga Policia e Kosovës arrijnë kulmin në vitin 2017, ndërsa rastet e raportuara nga SMIA janë më të larta në vitin shkollor 2022-2023. Numri i rasteve të raportuara nga SMIA është më i vogël në krahasim me ato të Policisë së Kosovës, ndoshta për shkak të mos raportimit të plotë nga drejtorët e shkollave, siç është cekur edhe në raportin e MASHTI. Për më shumë, kjo nënkupton se rastet në Policinë e Kosovës më gjasë raportohen nga nxënësit dhe prindërit dhe përkundër raportimit ato nuk duket se reflektohen në SMIA.
28. Sipas raportit të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF “Karta e Vlerësimit”¹⁴ është konstatuar se protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar po zbatohet pjesërisht për shkak të mungesës së mbikëqyrjes efektive. Kjo konfirmohet nga numri i vogël i rasteve të dhunës të raportuara në SMIA. Në vitin shkollor 2021/22, janë raportuar vetëm 39 raste të dhunës në shkollë, ndërsa në vitin shkollor 2022/23, janë raportuar vetëm 44 raste. Të dhënat nga MASHTI tregojnë se raportimet në SMIA janë të pakta dhe numri i shkollave që raportojnë është i vogël, duke sugjeruar që nuk raportohen të gjitha rastet. Këto të dhëna janë po ashtu në disproporcion me rastet e raportuara në Policinë e Kosovës. Më tej në këtë raport theksohet se sa i përket dhunës në shkollë, sipas Policisë së Kosovës, ka pasur rritje të madhe të incidenteve të dhunës në shkollë, krahasuar me vitet paraprake. Gjatë vitit 2022 janë raportuar gjithsej 592 raste të incidenteve në shkollë dhe përreth tyre. Pra

¹⁴ https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2024/03/Raporti_Karta-e-vleresimit_FINAL.pdf

mospërputhja e madhe e të dhënave, jep indikacion që sistemi i parandalimit dhe trajtimit të dhunës brenda shkollave nuk është duke funksionuar.

VLERËSIMI I TË DHËNAVE TJERA NË LIDHJE ME DHUNËN NË SHKOLLA

Të dhënat nga studimet për dhunën në mes bashkëmoshatarëve në Kosovë

29. Në një studim hulumtues i viktimizimit të nxënësve të shkollës së mesme në Kosovë dhe lidhjet e tij¹⁵ i cili përfshiu 13 komuna dhe 12,000 nxënës të klasave 6-9, duke zbuluar se 77% e nxënësve raportuan se kanë përjetuar të paktën një formë dhune gjatë muajit të fundit. Ndër llojet e dhunës, 61% raportuan dhunë verbale, 66.3% dhunë psikologjike, 9.4% dhunë seksuale, 45% dhunë fizike, 32.4% kishin parë nxënës me thikë në shkollë, dhe 9.7% kishin parë nxënës me armë zjarri, ndërsa 2.2% ishin kërcënuar me armë. Në një tjetër studim përkitazi me ekspozimin e fëmijëve ndaj viktimizimit të bashkëmoshatarëve,¹⁶ i realizuar në Prishtinë dhe Graçanicë me 385 nxënës shqiptarë dhe serb të klasave 5-9, 33% e nxënësve raportuan se janë ngacmuar në shkollë gjatë muajve të fundit. Përqindjet e tjera të raportimit për ngacmime ishin: 4% për "2 ose 3 herë në muaj", 7% për "2 ose 3 herë në javë", 2% për "një herë në javë", dhe 5% për "disa herë në javë".
30. Sipas një studimi lidhur me dallimet gjinore në vlerësimin e treguesve të sigurisë në shkolla sipas fëmijëve në shkollat e mesme në Prizren,¹⁷ me 1,050 nxënës me moshë mesatare 15 vjeç, tregoi se 12.2% ishin shuplakuar, 28.8% ishin pickuar, 11.5% ishin shkelmuar, 40.5% ishin shtyrë, 14.9% ishin kërcënuar, dhe 14.2% ishin detyruar të japin para.
31. Instituti Pedagogjik i Kosovës në një hulumtim "*Dhuna dhe siguria në shkolla (2015)*"¹⁸ analizoi 380 nxënës të klasave 10 dhe 11, duke gjetur se 39.31% ishin shtyrë, 13.64% ishin sulmuar fizikisht me shuplaka, grushte ose shkelma, 15.00% ishin kërcënuar për të dhënë para ose sende të tjera me vlerë, 2.94% ishin prekur apo ngacmuar seksualisht, 59.52% ishin bërë objekt thashethemesh, 48.11% ishin qeshur me ta dhe ishin quajtur me emra fyes, 26.27% kishin pasur informacione apo foto lënduese të shpërndara online, dhe 25.20% kishin pasur pronën e tyre të dëmtuar qëllimisht. Këto të dhëna tregojnë një prevalencë të lartë të dhunës në shkolla në Kosovë dhe janë thelbësore për të kuptuar natyrën dhe përmasat e problemit. Krahasuar me numrin shumë më të ulët të rasteve të raportuara nga SMIA dhe Policia e Kosovës, këto rezultate sugjerojnë se dhuna në shkolla është një problem shumë më i përhapur sesa tregon raportimi zyrtar. Pavarësisht dallimeve metodologjike në studime dhe grup moshës së përfshirë, këto të dhëna tregojnë një prezencë më të madhe të dhunës sesa ajo që raportohet nga burimet zyrtare.
32. Sipas një raporti të UNDP-së (2014), në Prishtinë, 21% e nxënësve dhe 47% e prindërve ndihen të pasigurt në shkollë.¹⁹

¹⁵ Kelmendi, K., Arënlui, A., Benbenishty, R., Astor, R. A., Hyseni Duraku, Z., & Konjufca, J. (2023). An exploratory study of secondary school student victimization in Kosovo and its correlates. *Journal of school violence*, 22(4), 459-473.

¹⁶ Agani, N. (2019). Children's Exposure to Peer Victimization, Bullying, Perceptions of School Safety, and School Climate Among Albanian and Serbian Students in Kosovo (Doctoral dissertation, Clemson University).

¹⁷ Zaplluzha, S., & Shahini, M. (2015). Gender differences in the evaluation of school safety indicators according to adolescents in higher secondary schools in Prizren. *International Journal of Adolescence and Youth*, 21(1), 27-33. <https://doi.org/10.1080/02673843.2015.1027>

¹⁸ <https://ipkmasht.rks-gov.net/2015/01/04/dhuna-dhe-siguria-ne-shkolla/>

¹⁹ https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/ks/action_papper_alb.pdf

33. Sipas një studimi të Institutit Pedagogjik të Kosovës dhuna verbale ndaj nxënësve (2012), i kryer me 214 nxënës dhe 52 mësime dhënë në 9 komuna të Kosovës, 15.12% e mësimeve përdorin gjuhë fyese çdo ditë, ndërsa 17.09% e bëjnë shpesh dhe 19.17% ndonjëherë. Për më tepër, 40% e nxënësve janë pajtuar me deklaratën se, në vend të mësimeve, edhe ata do të vepronin njësoj duke përdorur dhunë verbale.²⁰

34. Tabela në vijim përmbledh të dhënave të prezantuara më sipër më në detaje në përqindje dhe lloje të dhunës.

Studimi dhe viti	Komunat/Numri i nxënësve të përfshirë në studim	Llojet e dhunës dhe përqindja e raportuar nga mostra
Kelmendi et al., 2023	13 komuna/12.000 nxënës të klasave 6-9	Dhuna e përgjithshme: 77% e nxënësve raportuan se kanë qenë të dhunuar të paktën nga një lloj dhune gjatë muajit të fundit. Dhuna verbale (sharje ose abuzim verbal): 61%. Dhuna psikologjike: 66.3%. Dhunë seksuale (kanë provuar të ju prekin, puthin pa pëlqimin tuaj) 9.40%. Dhuna fizike (shtyrje dhe kapje) 45%. Keni parë nxënës me thikë në shkollë 8.4%. Keni parë nxënës me armë zjarri në shkollë: 32.7%. Kërcënime me armë: 2.2%.
Natyra Agani, 2019	Prishtinë dhe Graçanicë /385 nxënës shqiptarë dhe serb klasa 5 deri 9	33% kanë përjetuar ngacmime në shkollë gjatë muajve të fundit. 4% raportuan se kanë përjetuar ngacmime "2 ose 3 herë në muaj". 7% raportuan "2 ose 3 herë në muaj". 2% raportuan "një herë në javë"; dhe 5% raportuan "disa herë në javë"
Zapluzha & Shahini, 2015	1050 nxënës, mosha mesatare 15	Shuplakë (12.2%) Pickim (28.8%) Shkelmim (11.5%) Shtyrje (40.5%) Kërcënuar (14.9%)

²⁰ <https://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/12/Dhuna-verbale-ndaj-nxenesve.pdf>

		Ju kanë marrë paratë (14.2%)
Instituti Pedagogjik, 2015	380 nxënës të klasave 10 dhe 11	Shtyrë 39.31% Sulmuar fizikisht (godit me shuplakë, grushte ose shkelma) 13.64% Kërcënim për lëndim nëse nuk jepni (p.sh. para, telefon celular, veshje, etj.) 15.00% Prekur apo ngacmuar seksualisht 2.94% Bëjnë thash e theme për ju 59.52% Qeshet me ju dhe ju drejtohet me emra fyes 48.11% Shpërndarë informacione/foto lënduese online 26.27% Thyer/dëmtuar qëllimisht pronën tuaj 25.20%
UNDP, 2014 ²¹	353 nxënë, 82 prindër, 84 mësimdhënës, Prishtinë	21% e nxënësve dhe 47% e prindërve ndihen të pasigurt në shkollë. 45% e nxënësve deklaruan se një mësimdhënës ka goditur ose rrahur një nxënës gjatë gjysmë vjetorit të kaluar. 45% e nxënësve raportuan se një mësimdhënës ka ofenduar një nxënës.
Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2012	214 nxënës dhe 52 mësimdhënës, në 9 komuna të Kosovës	Mësimdhënësit përdorin gjuhë fyese çdo ditë në situata të caktuara, 15.12%. Mësimdhënësit shpesh përdorin gjuhë fyese në situata të caktuara, 17.09%. Mësimdhënësit ndonjëherë përdorin gjuhë fyese në situata të caktuara, 19.17%. Nxënësit pajtohen me deklaratën për përdorimin e dhunës verbale nga mësimdhënësit “Sikur të isha në vendin e tyre edhe unë do të veproja njësoj si ata” 40%

35. Në përgjithësi, rezultatet e studimeve tregojnë një prevalencë të lartë të dhunës së raportuar nga nxënësit dhe praninë e të gjitha formave të dhunës sipas hulumtimeve të kryera.

Të dhënat nga studimet për dhunën në shkolla nga mësimdhënësit drejtuar nxënësve

²¹ https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/ks/action_papper_alb.pdf

36. Në një studim të realizuar në vitin. (2023)²², në 13 komuna me pjesëmarrjen e 12,000 nxënësve, rezultatet tregojnë nivele alarmante të viktimizimit nga stafi shkollor. Të dhënat zbulojnë se 12.7% e nxënësve janë tallur, fyer ose poshtëruar, 8.3% janë sharë, 9.6% janë kapur dhe shtyrë me qëllim, 8.1% janë goditur ose janë goditur me grusht, 15.8% janë pickuar ose shuplakosur, 2.5% kanë përjetuar komente seksuale, 2.3% janë prekur ose janë tentuar të preken në mënyrë seksuale, dhe 2.4% kanë përjetuar oferta seksuale. Përgjithësisht, 25.9% e nxënësve kanë përjetuar të paktën një formë viktimizimi. Këto shifra janë më të larta krahasuar me ato të shumë vendeve të tjera, duke theksuar nevojën për ndërhyrje të menjëhershme dhe masa parandaluese për të mbrojtur nxënësit nga keqtrajtimi në mjediset shkollore. Po ashtu këto të dhëna japin indikacion që mësimitdhënësit kanë nevojë për trajnime për metoda alternative të disiplinimit të nxënësve.

37. Tabela në vijim paraqet përmbledhjen e llojeve të dhunës nga mësimitdhënësit drejtuar nxënësve në shkollat fillore të Kosovës (klasa 6-9).

Studimi dhe viti	Komunat/Numri i nxënësve të përfshirë në studim	Llojet e dhunës dhe përqindja e raportuar nga mostra
Arënlju et al, 2023	13 komuna me 12.000 nxënës	Tallë, fyer ose poshtëruar 12.7% Ju ka sharë 8.3% Kapur dhe shtyrë me qëllim 9.6% Goditur ose goditur me grusht 8.1% Pickuar ose shuplakë 15.8% Bërë komente seksuale 2.5% Prekur ose tentuar të prekë (në mënyrë seksuale) 2.3% Ofruar veten seksualisht 2.4% Të paktën një lloj viktimizimi 25.9%

Përgatitja e mësimitdhënëseve për të adresuar çështjet e dhunës në shkollë

38. Nga studimi i realizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës i theksuar më sipër, është evidentuar se niveli i trajnimeve përkatëse për mësimitdhënësit në lidhje me dhunën dhe sigurinë në shkollë është i ulët. Prej 139 mësimitdhënëseve të anketuar, vetëm 37.41% kanë ndjekur trajnime të lidhura me dhunën dhe sigurinë. Këto trajnime përfshijnë trajnimet mbi të drejtat e fëmijëve (67.31%), trajnimet psiko-sociale (40.38%), menaxhimin e konflikteve (15.38%) dhe trajnimet mbi diskriminimin, barazinë gjinore, traumën, shëndetin dhe kujdesin për fëmijët (11.54%). Në mënyrë të veçantë, vetëm 15% (8 nga

²² Arënlju, A., Benbenishty, R., Kelmendi, K., Duraku, Z. H., Konjufca, J., & Astor, R. A. (2022). Prevalence and predictors of staff victimization of students in Kosovo. *School psychology international*, 43(3), 296-317.

139) e mësimdhënësve kanë marrë trajnim specifik për menaxhimin e konflikteve, duke treguar mungesën e theksuar të trajnimeve adekuate në këtë fushë.

39. Në një tjetër studim të realizuar nga Departamenti i Psikologjisë në Universitetin e Prishtinës në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prizrenit me 455 mësimdhënës në vitin 2022, janë gjetur të dhëna të rëndësishme lidhur me çështjet e dhunës në shkolla. Studimi tregoi se: 7.5% e mësimdhënësve raportuan se nuk ndihen të sigurt në mjediset shkollore; 42% e mësimdhënësve deklaruan se shpenzojnë një pjesë të madhe të orës mësimore në disiplinimin e nxënësve; Vetëm 11.2% thanë se shkollat e tyre kanë programe parandaluese për problemet në shkollë; 5.3% e mësimdhënësve raportuan se janë sharë, kapur apo shtyrë nga nxënësit; 3.7% raportuan se janë kërcënuar për t'u goditur nga nxënësit, dhe 2% raportuan se janë goditur nga nxënësit.
40. Sa i përket trajnimeve, nga lista prej 13 temave për trajnim nga i njëjti hulumtim, tema e disiplinës dhe menaxhimit të nxënësve me probleme në sjellje ishte prioriteti i dytë i mësimdhënësve. Po ashtu, 8% e mësimdhënësve raportuan se mësuesit ose punonjësit e tjerë të shkollës i shajnë, ofendojnë apo poshtërojnë verbalisht nxënësit. Këto të dhëna tregojnë se jo vetëm nxënësit, por edhe mësimdhënësit janë të rrezikuar nga viktimizimi në mjediset shkollore dhe se ka nevojë urgjente për trajnime të mësimdhënësve për të adresuar problemet me nxënësit përfshirë disiplinimin. Gjithashtu, sipas mësimdhënësve gati 90% e shkollave nuk kanë programe të mirëfillta parandaluese për të trajtuar problemet e dhunës në shkollë.

Të dhëna të tjera relevante në lidhje me dhunën në shkolla në Kosovë

41. Më 15 nëntor 2016, Avokati i Popullit publikoi një opinion në lidhje me ndikimin e dhunës në shëndetin dhe jetën sociale të fëmijëve, si dhe masat që duhet ndërmarrë institucionet përgjegjëse. Qëllimi i këtij opinion ishte tërheqja e vëmendjes përkitazi me ndikimin negativ të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe rëndësinë e parandalimit të saj, duke e identifikuar, referuar dhe trajtuar me kohë. Po ashtu më 9 nëntor 2022, Avokati i Popullit kishte publikuar raportin me rekomandime *ex officio* nr. 331/2022 lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar të Kosovës me të drejtat e fëmijëve në arsim.²³ Në këtë raport pos tjerash janë theksuar edhe faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen në arsimin e përgjithshëm parauniversitar. Njëri prej këtyre faktorëve është përmendur dhuna në shkollë. Është thënë se elementet që shkaktojnë dhunën në shkollë gjenden si brenda ashtu edhe jashtë kampuseve shkollore. Dhuna në shkollë është e ndërlidhur me dhunën në familje, bullizmin, shpërndarjen e substancave dhe drogave të paligjshme, i pranishëm dhe aktivitetet e bizneseve abuzive në afërsi të shkollave, i qasjes së lehtë të qytetarëve në armë të ndryshme etj. Gjithashtu është theksuar se të gjithë këta faktor mund të ndikojnë në përhapjen e dhunës në shkolla, e cila pastaj shkakton pasoja të rënda për fëmijën dhe shoqërinë.
42. Në bazë të anketës Zërat e rinj një nga gjetjet kryesore ka dalë se 78% e fëmijëve raportojnë se bullizmi është shumë ose mesatarisht i pranishëm në shkollën e tyre. Fëmijët identifikojnë më tej TikTok-un (78%), Snapchat-in (57%), shkollat dhe hapësirat

²³<https://oik-rks.org/2022/11/10/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-3312022-lidhur-me-perafrimin-e-dispozitave-te-sistemit-te-arsimit-te-pergjithshem-parauniversitar-te-kosoves-me-te-drejtat-e-femijeve-ne-arsim/>

publike (52%), Instagramin (45%) dhe Facebook-un (28%) si hapësira ku bullizmi ndodhë shpesh ose gjithmonë.²⁴

43. Bullizmi mund të ndodhë në mjedise të ndryshme, duke përfshirë shkollat, këndet e lojërave, në internet dhe në shtëpi. Bullizmi mund të ketë pasoja të rënda negative për viktimën, duke përfshirë dëmtimin fizik dhe emocional, vështirësitë akademike dhe izolimin social.²⁵ Ekziston një kornizë ligjore koherente bazike dhe sistematike në lidhje me dhunën, por pa u kufizuar në aktet ligjore të cilat po theksohen. Kushtetuta ka përcaktuar se secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.²⁶ Ndërsa Konventa për të drejtat e fëmijëve ka përcaktuar se shtetet palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.²⁷ Ndonëse, KDF-ja nuk e përkufizon në mënyrë eksplicite bullizmin, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve ka shtjelluar kuptimin e tij për bullizmin përmes Komentit të Përgjithshëm nr. 13 mbi të drejtën e fëmijëve për të jetuar të lirë nga të gjitha format e dhunës. Komiteti fillimisht ofron një koncept të gjerë të bullizmit si veprime negative të përsëritura që synojnë një individ ose grup. Komiteti gjithashtu vë në pah se bullizmi është i bazuar në dinamika të pabarabarta të pushtetit ku ekziston një çekuilibër i pushtetit midis dhunuesit dhe viktimës, duke e bërë viktimën të pambrojtur. Gjithashtu, veprimet e dhunuesit synojnë të shkaktojnë shqetësim, frikë ose poshtërim për viktimën.²⁸
44. Ndërsa format specifike të bullizmit të identifikuar nga Komiteti i KDF-së janë: bullizmi fizik, verbal, psikologjik dhe kibernetik. Bullizmi fizik nënkupton goditjen, shkelmimi, shtyrja, pengimi dhe forma të tjera të agresionit fizik. Bullizmi verbal nënkupton thirrjet, ofendimet, ngacmimet, përhapja e thashethemeve, kërcënimet dhe forma të tjera të abuzimit verbal. Bullizmi psikologjik shprehet përmes përjashtimit social, frikësimit, manipulimi emocional dhe forma të tjera të abuzimit emocional. Si dhe bullizmi kibernetik do të thotë përdorimi i pajisjeve elektronike për të ngacmuar dikë, si dërgimi i mesazheve kërcënuese, postimi i përmbajtjeve të dëmshme në internet dhe imitimi i viktimës.²⁹ Shtetet palë në KDF-së kanë detyrimin për të parandaluar dhe trajtuar të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve, duke përfshirë edhe bullizmin. Kjo përfshin miratimin e ligjeve dhe politikave, ofrimin e programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit dhe krijimin e shërbimeve mbështetëse për viktimat.
45. Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2024 zhvilloi takime me fëmijët në shkolla dhe përgjatë bashkëbisedimeve me ta nxënësit pohan se përdoret dhuna fizike ndaj tyre dhe se ka edhe ngacmime seksuale në shkollë nga ana e mësimdhënësve por sipas tyre ato mbulohen vazhdimisht nga menaxhmenti e nuk raportohen, apo edhe kur raportohen nuk trajtohen meritoreisht.

²⁴ <https://resourcecentre.savethechildren.net/pdf/Zerat-e-Rinj-2024.pdf/>

²⁵ Manuali i zbatimit për Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, i qasshëm në: <https://www.unicef.org/lac/media/22071/file/Implementation%20Handbook%20for%20the%20CRC.pdf>

²⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 50.

²⁷ Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, neni 19.

²⁸ Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, Komenti nr. 13: https://www2.ohchr.org/english/bodies/crc/docs/crc.c.gc.13_en.pdf

²⁹ Manuali i zbatimit për Konventën për të Drejtat e Fëmijëve.

46. Sipas studimit të realizuar nga UNDP³⁰ në vitin 2014, kodet e mirësjelljes janë konsideruar si një mjet efikas për parandalimin e dhunës dhe promovimin e sigurisë në shkolla. Sipas këtij studimi, 97% e mësimeve të raportuar se shkollat e tyre kanë një kod të mirësjelljes. Megjithatë, 25% e nxënësve dhe prindërve nuk janë të informuar nëse shkolla e tyre ka një kod të tillë. I njëjti studim thekson se për të adresuar problemet e sigurisë, shumica e shkollave kanë themeluar Këshillin e Sigurisë, i cili përbëhet nga prindër (40%), arsimtarë (37%), drejtori (37%) dhe nxënës (27%). Vetëm 49% e këtyre këshillave janë funksionale, ndërsa 35% e mësimeve të raportuar se shkolla e tyre ose nuk ka një këshill të sigurisë ose nuk janë të informuar për ekzistencën e tij. Në shkollat ku këshillat e sigurisë janë funksionale, takimet raportohen të jenë të shpeshta. 26% e mësimeve të raportuar se këshilli është mbledhur dy herë gjatë gjysmë vjetorit të parë, 10% kanë raportuar tre takime, dhe 26% kanë raportuar më shumë se tre takime gjatë po të njëjtës periudhë. Këto të dhëna tregojnë se organizimi dhe funksionaliteti i këshillave të sigurisë ndryshon nga shkolla në shkollë, duke reflektuar nivele të ndryshme të angazhimit dhe efektivitetit të tyre.

Iniciativa dhe veprime për parandalimin e dhunës në shkolla

47. Ka pasur aktivitete të ndërmarra nga institucionet publike, shoqëria civile dhe akterë të tjera për parandalimin dhe adresimin e dhunës në shkolla. Projektet e përshkruara më poshtë në një mënyrë tregojnë për burimet dhe potencialet për aktivitete për parandalimin dhe adresimin e dhunës në shkollat e Kosovës. Këto ndërhyrje sugjerojnë se ka potencial për ndërhyrje në shkallë më të gjerë me mbështetje institucionale dhe ndër sektoriale për parandalimin dhe adresimin e dhunës në shkolla. Sipas objektivit të projektit "*Parandalimi i Dhunës në Shkollë*"³¹ ishte krijimi i shkollave të mesme dhe fillore në Kosovë si mjedise miqësore dhe të lira nga dhuna. Aktivitetet përfshinin trajnime dhe takime me përfaqësues të DKA-së, krijimin e Komiteteve për të Drejtat e Fëmijëve, dhe organizimin e konferencave rajonale dhe Panairit të të Drejtave të Fëmijëve. Rezultatet përfshijnë fuqizimin e rrjetit për parandalimin e dhunës, krijimin e një rrjeti qendror, miratimin e një protokollit dhe hartimin e planit kombëtar për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës.

48. Udhëzuesi për Zbatimin e Rregullores QRK 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar³² synon të ofrojë udhëzime specifike për institucionet e arsimit parauniversitar për zbatimin e Rregullores QRK 21/2013, e cila fokusohet në parandalimin dhe referimin e dhunës në shkolla. Ai përshkruan llojet e ndryshme të dhunës, përfshirë dhunën fizike, verbale, emocionale, seksuale dhe digjitale, dhe ofron strategji për parandalimin e dhunës përmes krijimit të një kulture respekti dhe përfshirjeje, aktiviteteve sensibilizuese, sigurimit të një mjedisi mësues pozitiv dhe ofrimit të shërbimeve këshillimore. Dokumenti detajon procedurat për identifikimin dhe referimin e rasteve të dhunës, duke përfshirë njohjen e shenjave paralajmëruese, marrjen serioze të kërcënimeve dhe përfshirjen e prindërve. Tutje dokumenti thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional dhe përfshirjen e aktorëve të ndryshëm, për të siguruar një qasje holistike dhe të koordinuar në adresimin e dhunës në shkolla.

³⁰https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/ks/action_papper_alb.pdf

³¹ Qendra Kosovare për Edukim (KEC) - 2010-2012 Parandalimi i dhunës në shkolla (financuar nga UNICEF-i)

³² <https://masht.rks-gov.net/udhezes-per-zbatimin-e-rregullores-nr-21-2013/>

49. Doracaku për parandalimin e dukurive negative në shkolla të mesme të larta³³ synon të parandalojë dukuritë negative në shkollat e mesme të larta përmes procesit edukativo-arsimor, duke rritur vetëdijesimin për përdorimin e substancave narkotike, dhunën, diskriminimin dhe keqpërdorimin e teknologjisë informative. Doracaku përshkruan rolin e shkollës dhe kurrikulave në parandalimin e këtyre dukurive, informacione mbi adoleshencën dhe rreziqet e saj, si dhe përgjegjësitë qytetare. Dokumenti ofron udhëzime për planifikimin dhe realizimin e orëve mësimore, modele të orëve mësimore për temat kyçe dhe një modul trajnimi. Synohet përmirësimi i performancës së mësimdhënies dhe mësim nxënies, duke kultivuar vlera qytetare dhe sjellje të shëndosha dhe shmangur situatat konfliktuale brenda dhe jashtë shkollës.
50. Modulet tematike për mbrojtjen e fëmijëve³⁴ synojnë të sigurojnë udhëzime për stafin e shkollës për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për nxënësit, duke promovuar kulturën e respektit dhe përfshirjes me 12 module në tema të ndryshme, si parandalimi i dhunës në familje, trafikimi i fëmijëve etj. Moduli 1: Parandalimi dhe referimi i dhunës në shkolla synon të udhëzojë stafin e shkollës në parandalimin dhe referimin e dhunës, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës për nxënësit. Theksohet rëndësia e parandalimit përmes zhvillimit të një kulture respekti, aktiviteteve sensibilizuese, një mjedisi mësimor pozitiv dhe inkurajimit të sjelljeve pozitive. Ofrimi i shërbimeve këshillimore dhe monitorimi i mediave sociale janë gjithashtu të rëndësishme. Referimi dhe raportimi i dhunës kërkojnë njohjen e shenjave paralajmëruese, marrjen serioze të kërcënimeve dhe përfshirjen e prindërve, duke ndjekur protokollin e shkollës. Parandalimi dhe referimi efektiv kërkojnë bashkëpunimin e stafit, nxënësve, prindërve dhe komunitetit për të krijuar një mjedis të sigurt dhe miqësor.
51. Udhëzuesi për mësimdhënës dhe prindër “*Siguria e fëmijëve në internet*”³⁵ synon të ndihmojë prindërit dhe edukatorët në mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në internet dhe dhuna në shkolla, duke rritur vetëdijen për rreziqet dhe ofruar masa mbrojtëse. Udhëzuesi përmban informata për qasjen e sigurt në internet dhe këshilla për prindërit dhe edukatorët për të siguruar që fëmijët përdorin internetin në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt, duke promovuar një mjedis mbështetës dhe edukativ. Përmes këtij udhëzuesi, synohet të rritet ndërgjegjësimi dhe të sigurohen mjete për të mbrojtur fëmijët nga rreziqet në internet dhe dhuna në shkolla, duke përfshirë masa konkrete për monitorimin dhe mbrojtjen e tyre.

Të dhënat nga fokus grupet me prindër, mësimdhënës dhe me nxënës

52. Janë realizuar dy fokus grupe me prindër, dy fokus grupe me mësimdhënës dhe dy fokus grupe me nxënës në lidhje me dhunën në shkolla të zhvilluara për qëllimet të këtij raporti. Po ashtu është zhvilluar një intervistë me psikologe shkollore. Një nga secila kategori është realizuar në tri shkolla të ndryshme në kryeqytet, ndërsa 3 të tjera me të gjitha kategoritë e përmendura janë zhvilluar në një zonë rurale të rajonit të Lipjanit.
53. Në fokus grupin me prindër në qytet, dy prindër raportuan incidente serioze të dhunës. Njëri prej tyre tregoi se ishte detyruar të ndryshonte shkollën e fëmijës për shkak të dhunës së përsëritur ndaj djalit të tij dhe mungesës së ndërhyrjes nga drejtori dhe stafi i

³³<https://masht.rks-gov.net/DORACAK-PER-PARANDALIMIN-E-DUKURIVE-NEGATIVE-NE-SHKOLLA-TE-MESME-TE-LARTA/>

³⁴ <https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/09/Moduli-ALB.pdf>

³⁵ <https://www.childrights-ks.org/site/assets/files/1391/udhezues-per-prinder-dhe-edukator.pdf>

shkollës për të marrë masa ndaj dhunuesit. Sipas tij, kjo situatë ka shkaktuar shqetësime dhe parehati të vazhdueshme në familjen e tyre për një periudhë të gjatë. Përkundër ankesave të shumta, ai shprehu zhgënjimin e tij me mosveprimin ndaj nxënësit që kishte shkaktuar dhunën. Një prind tjetër raportoi se përlëshja që fëmija i saj kishte përjetuar në shkollë ishte publikuar në rrjetet sociale dhe tani e kishte të pamundur ta fshinte atë nga interneti. Në dallim nga rasti i parë, ajo tregoi se shkolla kishte ndërmarrë masa disiplinore ndaj të gjitha palëve të përfshira në incidentin e dhunës. Prindërit posaçërisht në qytet raportuan të jenë të shqetësuar për sigurinë fizike të fëmijëve të tyre në shkollë dhe në oborr të shkollës.

54. Në përgjithësi (në qytet dhe fshat), prindërit raportuan se mënyra më e zakonshme e menaxhimit të dhunës midis bashkëmoshatarëve është përmes ndërmjetësimit, ku kërkohet pajtim nga palët e përfshira. Në këto raste, prindërit ftohen gjithashtu për konsultim dhe për të kontribuar në zgjidhjen e situatës. Prindërit raportuan se nuk kanë dëgjuar nga fëmijët të kenë marrë pjesë në ndonjë aktivitet apo program për parandalim të dhunës. Mësimdhënësit në qytet raportuan se kalojnë një kohë të gjatë duke menaxhuar problemet disiplinore në klasë. Kjo e dhënë është në përputhje me nevojat për trajnim të cilat janë raportuar nga mësimdhënësit në këtë studim. Gjithashtu, ata theksuan se masat aktuale disiplinore nuk janë të mjaftueshme për të reduktuar sjelljet e dhunshme, veçanërisht tek nxënësit me tendencë të vazhdueshme për dhunë. Mësimdhënësit sugjerojnë marrjen e masave më të rrepta ndaj ushtruesve të dhunës, duke përfshirë edhe ndëshkime financiare, si një mënyrë për të parandaluar sjelljet e dhunshme. Ata pohuan gjithashtu se shpesh, nxënësit në situata problematike thjesht transferohen nga një shkollë në tjetrën si pasojë e përjashtimeve, që shpesh mbetet masa e fundit disiplinore, pa zgjidhur në thelb problemin e sjelljes.
55. Mësimdhënësit raportuan se nuk kanë marrë trajnime adekuate dhe nuk posedojnë aftësitë e nevojshme për të zbatuar forma alternative të disiplinimit, siç është disiplinimi pozitiv apo metoda të tjera efektive që mund të përdoren në klasë. Këto qasje do të ishin të dobishme në trajtimin e nxënësve që shfaqin sjellje të dhunshme ose kanë probleme me sjelljen. Mungesa e këtyre aftësive pengon mësimdhënësit në menaxhimin e situatave të tilla në mënyrë konstruktive dhe parandaluese.
56. Mësimdhënësit raportuan se mos adresimi i dhunës midis bashkëmoshatarëve mund të çojë në përshkallëzimin e konflikteve edhe midis të rriturve, duke përfshirë prindërit dhe stafin e shkollës. Si shembull, ata përmendën një rast të Zllakuqanit në Lipjan, ku një mosmarrëveshje e vogël mes nxënësve u shndërrua në një konflikt të madh që përfshiu edhe familjarët dhe përfundoi me një vrasje, duke dëshmuar për seriozitetin e pasojave kur dhuna midis bashkëmoshatarëve nuk trajtohet në kohë. Kjo situatë thekson nevojën urgjente për ndërhyrje efektive dhe për zgjidhje të qëndrueshme në menaxhimin e konflikteve në shkolla. Mësimdhënësit në qytet dhe në fshat, përfshirë edhe menaxherin e shkollës në fshat, nuk ishin të informuar për Protokollin për Parandalimin e Dhunës në Shkollë, i cili rregullon përgjegjësitë e shkollave dhe institucioneve në rastet e situatave të dhunës në shkollë. Ata gjithashtu konfirmuan se ka të ngjarë që mos raportimi i dhunës nga shkollat dhe mospërputhjet mes statistikave të Policisë së Kosovës dhe SMIA të ndodhin për shkak se shkollat tentojnë të ruajnë reputacionin e tyre si institucione pa dhunë.

57. Nxënësit në zonën rurale që raportuan se kishin qenë të përfshirë në një përlëshje fizike treguan se u përjashtuan nga shkolla për tre ditë dhe u qortuan nga prindërit e tyre. Ata raportuan se konflikti midis bashkëmoshatarëve u menaxhua nga drejtori i shkollës në prani të prindërve, ku palët kërkuar falje dhe premtuan për përmirësim disiplinor. Nxënësit e kishin të qartë se përjashtimi do të pasonte nëse incidenti do të përsëritej do të ishte më i gjatë se herën e kaluar. Nxënësit raportuan se incidentet e dhunës fillimisht i raportohen kujdestarëve të klasës dhe nuk kishin njohuri të mëtejshme për procedurat e tjera. Nxënësit nuk raportuan ndonjë trajnim apo ligjëratë specifike për parandalimin e dhunës.
58. Më 15 prill 2025, Avokati i Popullit, priti në takim përfaqësues nga grupet e ndryshme të fëmijëve që angazhohen për të drejtat e fëmijëve. Fëmijët ishin përfaqësues nga Asambleja e fëmijëve të Prishtinës dhe Mitrovicës, grupi Respect Our Rights - ROR, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, si dhe HANDIKOS dhe grupi Hëna. Avokati i Popullit informoi fëmijët për përgatitjen e një raporti që trajton përgjegjësitë e shtetit lidhur me dhunën në shkolla. Gjatë diskutimit, u paraqitën gjetjet fillestare të hetimit dhe fëmijët ndanë mendimet e tyre për përballjet që ndodhin mes nxënësve dhe problemet e tjera të lidhura. Gjatë takimit, fëmijët ngritën disa shqetësime thelbësore që lidhen me sigurinë dhe mirëqenien e tyre në shkolla. Ata theksuan se dhuna në ambientet shkollore vazhdon të jetë një problem serioz dhe në rritje. U përmend përjetimi i dhunës psikologjike nga ana e mësuesve, si dhe presioni emocional që shpesh u ushtrohet nga prindërit, veçanërisht para mbajtjes së testeve. Një tjetër çështje shqetësuese ishte mungesa e psikologëve në shkolla dhe trajtimi i pamjaftueshëm i rasteve nga ana e tyre. Po ashtu, u theksua mungesa e kamerave funksionale të sigurisë në shumë shkolla, çka, së bashku me mangësitë e tjera në infrastrukturën e sigurisë, përbën rrezik për nxënësit. Fëmijët gjithashtu vunë në dukje mungesën e bashkëpunimit ndërmjet shkollave, policisë dhe Qendrave për Punë Sociale, duke theksuar se kjo shpesh çel në raportim pengon trajtimin efikas të rasteve, pasi shumë shkolla zgjedhin të mos i raportojnë për të ruajtur imazhin e tyre. U ngritën shqetësime edhe për bullizimin e nxënësve për shkak të veshjeve apo gjendjes së tyre ekonomike, për vështirësitë që përballen mësuesit në menaxhimin e situatave problematike, si dhe për mungesën e transportit të përshtatshëm për nxënësit me aftësi të kufizuara e që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në shëndetin e tyre psikologjik. Në fund, u theksua mungesa e kutive të ankesave nëpër shkolla dhe u kërkuar një prani më e rregullt dhe më e dukshme e zyrtarëve policorë brenda dhe përreth shkollave, si dhe adresimi më i mirë i çështjeve që lidhen me sigurinë kibernetike.

KONSTATIMET

59. Avokati i Popullit pas analizës dhe vlerësimit të informacionit të mësipërm konstaton se në shkollat e Kosovës ka një prani të dhunës ndaj nxënësve, e ushtruar si nga bashkëmoshatarët ashtu edhe nga mësimdhënësit.
60. Avokati i Popullit vlerëson se dhuna në shkolla është një fenomen shqetësues që ndikon negativisht jo vetëm në shëndetin mendor dhe fizik të nxënësve, por edhe në cilësinë e procesit edukativ. Prandaj, është e domosdoshme të hartohet një strategji e veçantë dhe e efektshme për trajtimin e këtij fenomeni në shkollat e Kosovës.

61. Avokati i Popullit vlerëson se autoritetet publike përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë hapa të mjaftueshëm për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, megjithëse korniza ligjore në Kosovë e ndalon ndëshkimin fizik dhe format e tjera të dhunës ndaj fëmijëve.
62. Avokati i Popullit vlerëson se mësimdhënësit përballen me vështirësi në menaxhimin e problemeve disiplinore dhe shprehin nevojën për trajnime në metoda alternative të disiplinimit. Nxënësit përjetojnë dhunë nga bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësit, duke treguar një mungesë të sigurisë fizike në ambientet shkollore. Kjo situatë thekson domosdoshmërinë e ndërhyrjeve urgjente për krijimin e një mjedisi të sigurt, mbështetës dhe të drejtë për të gjithë pjesëmarrësit në shkolla.
63. Avokati i Popullit vlerëson se prindërit shprehin shqetësime të theksuara për sigurinë e fëmijëve të tyre në shkolla dhe në disa raste janë detyruar të ndryshojnë shkollën e fëmijës për shkak të dhunës së përsëritur dhe mungesës së ndërhyrjes nga stafi shkollor.
64. Avokati i Popullit vlerëson se sistemi aktual i raportimit të dhunës në shkolla është joefikas duke e dëmtuar rëndë përgjegjësinë dhe llogaridhënien ligjore në lidhje me dhunën në këto institucione. Mungesa e një raportimi të duhur dhe efektiv mund të nënkuptojë se shumë raste dhune nuk janë adresuar fare ose nuk janë trajtuar siç duhet nga autoritetet shkollore.
65. Avokati i Popullit vlerëson se, megjithëse ekzistojnë politika ligjore dhe protokolle për parandalimin e dhunës në shkolla, zbatimi dhe monitorimi i këtyre masave në praktikë janë të pamjaftueshme.
66. Avokati i Popullit vlerëson se mosraportimi i dhunës nga shkollat e pengon njohjen dhe adresimin zyrtar të këtij problemi. Prandaj, ekziston një nevojë urgjente për forcimin e llogaridhënies dhe një monitorimi më rigoroz i zbatimit të kornizës ligjore, me theks të veçantë në Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla [...].”*

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

1. *Të forcohet mekanizmi i llogaridhënies për institucionet e arsimit parauniversitar në zbatimin e kornizës ligjore me një fokus të veçantë në Rregulloren nr. 21/2013, e cila përcakton protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në këto institucione.*

2. Të analizohet dhe vlerësohet shkalla e shfaqjes së dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, me qëllim që të merren masat e duhura dhe efektive për parandalimin dhe trajtimin e saj.
3. Të hartohet një strategji gjithëpërfshirëse multisektoriale, që përfshin ministrinë e linjës, si dhe një plan veprimi me masa konkrete, të përshtatshme dhe efektive për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në shkolla, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe aktet e tjera ligjore.
4. Të mbikëqyrë dhe inspektojë funksionimin e sistemit arsimor duke siguruar zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në fushën e arsimit parauniversitar, përfshirë ato që parashikojnë sanksione për dhunën në shkolla dhe zbatimin e legjislacionit të tanishëm.
5. Të garantojë që institucionet e arsimit parauniversitar të ofrojnë raporte periodike mbi rastet e dhunës në shkolla.

Komunës së Deçanit

1. Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.
2. Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunoi me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.
3. Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.
4. Të sigurohet që mësimmdhënësit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.
5. Të organizohen trajnime për mësimmdhënësit dhe stafin tjetër profesional me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.
6. Të zhvillohen hulumtime mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës duke u fokusuar në parandalimin dhe eliminimin e akteve dhe veprimeve të dhunshme në të gjitha marrëdhëniet brenda institucioneve arsimore.

Komunës së Dragashit

1. Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.
2. Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë

Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.

- 3. Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.*
- 4. Të sigurohet që mësimmhënësit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.*
- 5. Të organizohen trajnime për mësimmhënësit dhe stafin tjetër profesional, me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.*
- 6. Të zhvillohen hulumtime mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës, duke u fokusuar në parandalimin dhe eliminimin e akteve dhe veprimeve të dhunshme në të gjitha marrëdhëniet brenda institucioneve arsimore.*

Komunës së Fushë Kosovës

- 1. Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.*
- 2. Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.*
- 3. Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.*
- 4. Të sigurohet që mësimmhënësit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.*
- 5. Të organizohen trajnime për mësimmhënësit dhe stafin tjetër profesional, me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.*
- 6. Të zhvillohen hulumtime mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës, duke u fokusuar në parandalimin dhe eliminimin e akteve dhe veprimeve të dhunshme në të gjitha marrëdhëniet brenda institucioneve arsimore.*

Komunës së Ferizajt

1. *Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.*
2. *Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.*
3. *Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.*
4. *Të sigurohet që mësimitdhënësit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.*
5. *Të organizohen trajnime për mësimitdhënësit dhe stafin tjetër profesional, me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.*
6. *Të zhvillohen hulumtime mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës, duke u fokusuar në parandalimin dhe eliminimin e akteve dhe veprimeve të dhunshme në të gjitha marrëdhëniet brenda institucioneve arsimore.*

Komunës së Graçanicës

1. *Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.*
2. *Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.*
3. *Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.*
4. *Të sigurohet që mësimitdhënësit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.*
5. *Të organizohen trajnime për mësimitdhënësit dhe stafin tjetër profesional, me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.*

6. Të zhvillohen hulumtime mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës, duke u fokusuar në parandalimin dhe eliminimin e akteve dhe veprimeve të dhunshme në të gjitha marrëdhëniet brenda institucioneve arsimore.

Komunës së Hanit të Elezit

1. Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.
2. Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.
3. Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.
4. Të sigurohet që mësimmshënësit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.
5. Të organizohen trajnime për mësimmshënësit dhe stafin tjetër profesional, me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.
6. Të zhvillohen hulumtime mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës, duke u fokusuar në parandalimin dhe eliminimin e akteve dhe veprimeve të dhunshme në të gjitha marrëdhëniet brenda institucioneve arsimore.

Komunës së Istogut

1. Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.
2. Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.
3. Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.
4. Të sigurohet që mësimmshënësit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.

5. *Të organizohen trajnime për mësimdhënësit dhe stafin tjetër profesional, me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.*
6. *Të zhvillohen hulumtime mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës, duke u fokusuar në parandalimin dhe eliminimin e akteve dhe veprimeve të dhunshme në të gjitha marrëdhëniet brenda institucioneve arsimore.*

Komunës së Kaçanikut

1. *Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.*
2. *Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.*
3. *Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.*
4. *Të sigurohet që mësimdhënësit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.*
5. *Të organizohen trajnime për mësimdhënësit dhe stafin tjetër profesional, me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.*
6. *Të zhvillohen hulumtime mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës, duke u fokusuar në parandalimin dhe eliminimin e akteve dhe veprimeve të dhunshme në të gjitha marrëdhëniet brenda institucioneve arsimore.*

Komunës së Kamenicës

1. *Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.*
2. *Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.*
3. *Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.*

4. Të sigurohet që mësimehmënesit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.
5. Të organizohen trajnime për mësimehmënesit dhe stafin tjetër profesional, me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.
6. Të zhvillohen hulumtime mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës, duke u fokusuar në parandalimin dhe eliminimin e akteve dhe veprimeve të dhunshme në të gjitha marrëdhëniet brenda institucioneve arsimore.

Komunës së Klinës

1. Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.
2. Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.
3. Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.
4. Të sigurohet që mësimehmënesit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.
5. Të organizohen trajnime për mësimehmënesit dhe stafin tjetër profesional, me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.
6. Të zhvillohen hulumtime mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës, duke u fokusuar në parandalimin dhe eliminimin e akteve dhe veprimeve të dhunshme në të gjitha marrëdhëniet brenda institucioneve arsimore.

Komunës së Klllokotit

1. Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.
2. Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.

3. *Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.*
4. *Të sigurohet që mësimdhënësit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.*
5. *Të organizohen trajnime për mësimdhënësit dhe stafin tjetër profesional, me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.*
6. *Të zhvillohen hulumtime mbi gjendjen e të drejtave të fëmijës, duke u fokusuar në parandalimin dhe eliminimin e akteve dhe veprimeve të dhunshme në të gjitha marrëdhëniet brenda institucioneve arsimore.*

Komunës së Lipjanit

1. *Të përmirësojë infrastrukturën dhe sigurinë fizike në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndriçimin e duhur në oborret e shkollës, instalimin e kamerave të sigurisë dhe krijimin e zonave të sigurta për nxënësit.*
2. *Të sigurojë që Drejtoria Komunale e Arsimit të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, partnerë të tjerë dhe komunitetin, për të krijuar një mjedis të sigurt brenda dhe përreth institucioneve arsimore, duke mundësuar struktura mbështetëse për parandalimin dhe adresimin e incidenteve të dhunës në shkolla.*
3. *Të forcohet monitorimi në nivel lokal përmes inspektimeve të rregullta në shkolla, duke garantuar se ato po zbatojnë rregullat dhe ligjet përkatëse për parandalimin e dhunës në shkolla.*
4. *Të sigurohet që mësimdhënësit dhe stafi tjetër profesional të jenë të informuar mbi Rregulloren nr. 21/2013 për protokollin e parandalimit dhe referimit të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me parandalimin e dhunës.*
5. *Të organizohen trajnime për mësimdhënësit dhe stafin tjetër profesional, me fokus në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.*
